

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e nëntë e K.K-së, e cila do të mbahet më **27.10.2022** (e enjete) duke filluar në ora **10:00h**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K.;
2. Problemi i transportit publik (propozim i komitetit për komunitete)
3. Raporti financiar i tremujorit të trete për vitin 2022;
4. Raportim nga D.SH.P.M.Sh rreth infrastruktures publike (propozim i komitetit për komunitete);
5. Raportin nga D.A. rreth fillimit të vitit shkollor 2022/23;
6. Raport nga D.SH.P rreth pregaditjeve për sezonin e dimërit për vitin 2022/23;
7. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për Formimin e KKSB-së;
8. Raporti i Komisionit të Emërimit të Rrugëve;
9. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në Sallen e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 21.10.2022
Në: Novobërdë

zonj. Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPŠTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tetë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 27.09.2022, duke filluar në orën 10:10.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Kuvendit znj.Mirjana Simijonovic, zv.Kryesuesi i Kuvendit zt.Ramush Mehmeti, Nënkryetari i Komunës për Komunitete zt. Bajrush Ymeri, antarët e Kuvendit: Stojan Stanojevic, Dragana Dimic, Violeta Milosevic, Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhui, Dobrivoje Djordjevic, Abdyl Gashi, Vlora Vllasaliu, Stefan Kovacevic, Ivica Cenic, Drejtori i Financave zt.Milos Denic, Drejtori i Administratës zt.Serboljub Djokic, Drejtori i Urbanizmit zt.Bojan Peric, Drejtori i SH.P zt.Gafurr Vllasaliu, përfaqësuesi i OSBE-së, zyrtarë komunal dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit e cila pasi pershendeti të gjithë të pranishmi tha: konstatoj korumin prezent janë 14 anëtarë gjithësej të Kuvendit, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

R e n d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për thuarjen e marrëveshjes ndërkomunale dhe pruarja e vendimit që Kryetari i Komunës të vazhdoj me procedurat sipas udhëzuesit për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkombëtar;
3. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për mbikqyrjen e aktiviteteve të Komunës dhe Kuvendit;
4. Propozim dhe aprovim Buxheti për vitin 2023/25;
5. Formimi i komisionit 5 antarësh për mbikqyrjen e procedurave për përcaktimin e shtëpisë informative për përcjelljen e aktiviteteve të Komunës dhe Kuvendit;
6. Shqyrtimi i informates kthyesë nga Ministria rreth punës së komisionit për emrimin e rrugëve;
7. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për thuarjen e memorandumit të mirëkuptimit në mesë të Komunës së Novobërdës dhe shoqatës vullnetare të zjarrfiksave (SHMZ);
8. Me propozim të Komitetit për Komunitete Raportim nga kompania Hidromorava & D.SH.P rreth furnizimit me ujë të pijshëm për ujësjellës nënë mbykqyrje të kompanisë Hidromorava;
9. Të ndryshme;

Kryesuesja tha: i kam disa propozime ndryshime për rend të ditës: propozoj që piken e 6 ta anulojm pasi që nuk që nuk kanë ende informacione lidhur me këtë pikë, propozimi tjetër është që ta shtojm edhe një pikë shtesë: shpallja e tokës dhe objekteve me rëndësi publike në Komunën e Novobërdës si dhe propozoj që pika e dytë të kaloj te pika e pestë.

Kryesuesja i pyeti të pranishmit se a pajtoheni me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: kerkoj nga ju piken e dytë që ka të bëjë me buxhetin për vitin 2023/25 ta terhekim prej rendit të ditës për arsye që nuk ka ardh materiali me kohë dhe nuk kemi pas mundësi as me shqyrtu e as me diskutu që me pas mundësi edhe ne me i dhënë propozimet tona dhe vërejtjet tona sa i perket Buxhetit 2023/25. Ashtu siç është e parapar me rregullore edhe në raste të jashtëzakonshme 2 ose 3 ditë më herët duhet të vij materiali, andaj mendoj se edhe për këtë pikë duhet të shtyhet kjo mbledhje për seancën e radhës në mënyrë që të kemi kohë ta analizojm dhe të pregaditetmi për të dhënë kritikën tona ose të votojm kunder, ne sot jemi vetëm fizikisht dhe mundë të votojm vetëm si robota pasi që nuk po e diem se ku janë këto projekte dhe ku ka me u nda ky buxhet kaq i rëndësishëm për vitin e ardhshëm, këto kritika i ka pas edhe zv.kryesuesi që ka qenë shumë i rreptë në mandatin e kaluar e nuk e di se pse tash ka lejuar një gjë të tillë.

Kryesuesja tha: siç e dini edhe ju antarët e KPF-së se Drejtoria e Financave ka pasur disa vështërsi që ta pregadisë Buxhetin dhe nuk ka pasur mjaftë kohë, andaj e kemi menduar te pika e Buxhetit që të kemi një pauz prej 20-30min që të kemi kohë ta shqyrtojmë dhe analizojm këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 13 vota për, 1 kunder (Abdyl Gashi) aprovohet rendi i ditës me ndryshimet e propozuara

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime as vërejtje aprovohet njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Pika e dytë: Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për thuarjen e marrëveshjes ndërkomunale dhe pruarja e vendimit që Kryetari i Komunës të vazhdoj me procedurat sipas udhëzuesit për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkombëtar;

Kryesuesja për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Administratës që ta prezantoj këtë pikë.

Serbolub Djokic pasi pershendeti të pranishmit tha: qëllimi i kësaj pike është shqyrtimi i propozimit të Kryetarit në pruarjen e vendimit për të filluar procedurat në fushën e marrëveshjes së inspeksionit. Në drejtorin e inspeksionit janë të angazhuar dy punëtorë njëri në Drejtorin e urbanizmit dhe tjetri në inspeksion. Sipas meje Drejtoria e Inspeksionit është shtylla e Komunës. Ne si Komunë kemi puntorë shume dhe e kemi të pamundur që të shpallim konkurs për pranim të puntorëve të rinjë, qëllimi është të kërkojm puntorë shtesë andaj kërkoj që ta lidhim këtë marrëveshje e pastaj memorandum, kjo për fillim është vetëm një iniciativ pasi që për të mbuluar teritorin e Komunës sonë duhet ti kemi 10 punëtorë shtesë, ju faleminderit nese keni ndonjë pyetje urdhëroni.

Kryesuesja tha: ne si organ ligjvënës duhet ti shqyrtojm se a duhet Komuna të nënshkruaj marrëveshje me komunat e tjera dhe se a egziston mundësia për marrëveshje.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: këtu sot është duhur që të jetë Drejtori i Inspeksionit prezent që të na prezentoj këtë pikë, ka disa muaj që nuk kemi Drejtor të Inspeksionit, së pari këtu duhet të jetë Drejtori i Inspeksionit prezent, si të kërkojm ndihmë e përkrahje kur nuk kemi Drejtorë, edhe vet e ceku Drejtori i Administratës që është Drejtori shumë e rëndësishme sepse e dim në Komunën e Novobërdës çfarë ndërtime janë bërë pa leje dhe pa asnjë kriter dhe ne si Kuvend Komunal më së shumti duhet ti kushtojm rëndësi Drejtorisë së inspeksionit, ndërsa këtu po flitet për të kunderten, flitet që të shuhet kjo Drejtori, diçka që është absurde që nuk bënë fare të ndodh kjo, nuk ka asnjë Komunë që nuk e ka këtë Drejtori.

Stojan Stanojevic pasi pershendeti të pranishmit tha: vetëm të ndërlidhem edhe unë jam për atë që të formohen organet ekzekutive dhe e mirëpres këtë iniciativ dhe e përkrahi pasi që burimi kryesor duhet të jetë grumbullimi i tatimeve. Gjithashtu kjo struktur duhet të bij një vendim që Kuvendi të punoj në bazë të ligjit.

Kryesuesja tha: qëllimi është që të kemi sa më shumë marrëveshje në mes të Komunave dhe përfitues gjithëmonë do të jenë vet qytetarët.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 14 vota për aprovohet kjo pikë dhe mirret ky:

VENDIM

APROVOHET Iniciativa E Kryetarit të Komunes për vazhdimin e procedurave për nënshkrimin të memorandumit të bashkpunimit me komunën e Graçanices .

Pika e tretë: Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për mbikqyrjen e aktiviteteve të Komunës dhe Kuvendit; Kryesuesja tha: pika e tretë dhe e katërt janë të lidhura njëra me tjetren, të gjithë e dini bashkpunimin tonë si Kuvend me Kryetarin e Komunës dhe shpresoj se do të vazhdojmë me këtë bashkëpunim. Komisioni që do të formohet do të ketë 5 anëtarë, 3 nga ekzekutivi dhe 2 nga Kuvendit, në mënyrë që ti kemi propozimet nga Kuvendi, pra 1 antarë shqiptarë dhe 1 serb propozoj një pauzë prej 10min.

Pas pauzes 10 minuteshe mbledhja vazhdoi.

Kryesuesja tha: do ti kemi dy antarë në këtë komision nga Kuvendi, 1 nga shqiptarët dhe 1 nga serbet, ne nga serbet jemi pajtuar që në këtë komision të jetë Milica Jovanovic.

Kryesuesja kërkoj propozimin nga shqiptarët.

Pranvera Kastrati Gashi propozoi Ramush Mehmeti.

Selatin Nuhiu tha: ne pala shqiptare nuk jemi marrë vesh për të propozuar një antarë për komision andaj propozoj Abdyl Gashin.

Kryesuesja tha në rregull votojmë për të dy propozimet, kush është për propozimin e parë Milca Jovanovic dhe Ramush Mehmeti?.

12 vota për dhe 2 kunder (Abdyl Gashi, Selatin Nuhiu).

Kryesuesja tha: e kemi edhe propozimin e dytë.

Selatin Nuhiu tha: kryesuese votimi duhet të bëhet vetëm për palën e juaj njëherë për palën serbe e pastaj të votojmë për Ramush Mehmeti dhe Abdyl Gashin.

Kryesuesja tha: në rregull ska problem kush është për Ramush Mehmetin nga antërt e Kuvendit shqiptarë?.

3 vota për.

Selatin Nuhiu tha: të gjithë antarët e Kuvendit të votojnë e jo të ndahen veç shqiptarët e veç serbet, të votohen të tri propozimet veç e veç.

Kryesuesja tha: ashtu thash edhe unë në fillim por ju e komplikut, kush është për?

Milica Jovanovic - 14 vota për, Ramush Mehmeti - 10 vota për, Abdyl Gashi - 4vota për.

Kryesuesja tha: ne kemi zgjedhur antarët nga Kuvendi do të presim edhe propozimet nga ekzekutivi, e hudhi edhe niher në aprovim formimin e komisionit nga Kuvendi, me 13 vota për, 1 kunder (Abdyl Gashi) zgjedhet komisioni nga Kuvendi.

Pika e katërt: Propozim dhe aprovim Buxheti për vitin 2023/25;

Kryesuesja tha: për këtë pikë ja kaloj fjalën Drejtorit të Financave që ta prezantoj Buxhetin e pastaj bëjmë një pauzë në mënyrë që të keni kohë ta analizoni buxhetin pasi që materiali ka arritur pak me vones.

Milos Denic pasi pershendeti të pranishmit tha: fillimisht ju kërkoj falje që materiali ka arritur me vones, debatet publike i kemi mbajtur në fund të gushtit me qytetarë ku kemi dëgjuar kërkesat e tyre, i kemi pasur njoftimet publike për mbajtje të këtyre debateve. Ndoshta më shumë ju interesojnë investimet kapitale ku për vitin e ardhshëm janë planifikuar 70,000€ për infrastrukturë publike dhe 323,963€ për zhvillim ekonomik. Total buxheti për vitin e ardhshëm është 3,329,628€, për paga dhe medita janë 2,150,000€, për mallra dhe shërbime 415,781€, për shpenzime komunale 90,000€, për subvencione 260,000€ dhe për shpenzime kapitale 413,847€.

Kryesuesja propozoi pauzë prej 30min që të keni kohë ta analizoni buxhetin.

Me 9 vota për u vendos për pauzë 30min.

Pas pauzes 30minuteshe mbledhja vazhdoi.

Kryesuesja tha: besoj se keni pasur kohë që ta analizoni, e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: po shohë në këtë buxhet asfaltim të rrugëve, ndriqime, andaj po besoj se këto projekte fillojnë vitin e ardhshëm dhe përfundojnë edhe pse është një buxhet kogja problematik, aq sa pata mundësi me i shqyrtu disa projekte janë në të mirë e qytetarëve andaj unë jam për votimin e këtij buxhetit.

Selatin Nuhiu tha: më vjen mirë që sot ka ardh buxheti dhe jemi në diskutim, unë si PDK nuk kam marrë pjesë në investimet kapitale të cilat sigurisht se i ka bërë dikush tjetër, ose ndoshta janë kërkesa të debateve me qytetarë. Nuk po e di pse sot nuk po del që ti lexoj Ramush Mehmeti këto projekte, pasi që në mandatin e kaluar nuk ka pas lagje që nuk ka pas projekte ndërsa vetëm 30% janë realizuar dhe ka për obligim ndaj atyre qytetarëve pasi që ka bërë një premtim të rrem. Këtë herë po më vjen mirë që spo del me bë asi premtime. E kam një pyetje për Drejtorin se pse janë në list projektet që kanë qenë edhe në vitin e kaluar, si ka ndodhë kjo asfaltimi i rrugës Degellaj – Sallkaj do të kryhej këtë vit ku janë ndar 15,000€, e di se është shpall tenderi dhe është përfunduar projekti, nese ka mundësi të më tregoj se a është vazhdim i asaj rruge apo po bëhet projekt i ri si dhe ndertimi i kanalizimit në lagjen e re, lagje të reja ka shumë, nese ka mundësi dikush mem tregu se cila është ajo lagje e re nese ka mundësi drejtori një sqarim. Unë jam pro këtij buxheti e përkrahi.

Ramush Mehmeti tha: po më vjen mirë që të pakten po më permendet emri, kolegu Selatini ka harruar që ne kemi qenë bashkë, kemi qenë opozit në ekzekutiv, unë e kam pas shumicën në Kuvend dhe normal që kemi pasur fuqinë të propozojm dhe aprovojm projekte në kordinim me ju, shumë projekte kanë mbet në gjysëm për arsye të mjeteve buxhetore, e di që është shpall projekti por ajo rrugë këtë vit nuk ka mundësi me u kry.

Selatin Nuhiu tha: vitin e kaluar që kanë qenë propozimet pa ne nuk janë realizuar.

Violeta Milosevic tha: po pyes pse fshati Jasenovik nuk është në ndriqim publik dhe kanalizim.

Bajrush Ymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: pasi po diskutohet për buxhetin e mora obligim edhe unë që të ju njoftoj në pika të shkurtra, unë kam marrë pjesë në dy debate me qytetarë në fshatin Llabjan dhe Pasjak dhe natyrisht që i kam degjuar me kujdes të gjitha shtesimet që i kanë dhënë qytetarët gjatë këtyre dy debateve jam mundu me mbaj shenime gjatë gjithë kohës. Është e natyrshme që kërkesat vazhdimisht janë të mëdha dhe mundësit për me i realizu të gjitha ato kërkesa janë më të vogla e në veçanti në këtë vit kur po ballafaqohemi me një situat më të rëndë që çmimet e tregut për të kryer punët nuk janë sikur në vitin e kaluar. Pra prej të gjitha atyre kërkesave që i kemi marrë sa i perket buxhetit shqiptarë në bashkëpunim me këshilltarët Komunal, me zv.kryesuesin dhe Kryetarin e Komunës natyrisht jam mundu me i përfshi disa projekte që kanë qenë më të rëndësishme për qytetarët e Komunës sonë, e kemi asfaltimin e rrugës në fshatin Kufc ku ju kemi borxh pasi që 12 vite janë me Komunë tonë e ende se kanë rrugën e asfaltuar, pastaj e kemi lagjen Sallkaj, gjithashtu rrugën të Zejnaj ku është e pamundur të kalohet ajo rrugë, pastaj ndriqimin aty ku ka mbet te një pjesë në Llabjanë, Pasjak, kanalizimi është i paraparë në Pasjak në Llabjan tash me Drejtorin bisedum që të ndahen mjete edhe në Jasenovik të lagjja Mustafaj një pjesë e kanalizimit, gjithashtu kemi parapa pastrimin e lumit në Kufc dhe Kosaç, kemi parapa thurjen e varrezave në Pasjak, gjithashtu ndertimin e një aneksi të ambulanta në Llabjan pasi që kemi pas kërkesa edhe këtu që peleti po vendoset në hyrje të ambulantes. Pra jemi mundu që të gjitha me i përfshi nga pak por nuk do të thot që do të përfundoj këtu pasi që ne do të bëjm përpjekje edhe përmes Ministrisë së Infrastruktures dhe MAPL që të realizojm projekte dhe unë besoj shumë që vitin e ardhshëm qështja e asfaltimit të rrugëve përfundimisht do të zgjidhet, ju faleminderit.

Milica Jovanovic pasi pershendeti të pranishmit tha: unë si anëtare e kuvendit kam qenë në fshatin Jasenovik gjatë debateve publike dhe nuk kam degjuar që kanë kërkuar ndriqim publik.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 14 vota për nga të gjithë anëtarët prezent të Kuvendit aprovohet kjo pikë dhe mirret ky:

VENDIM

Për aprovimin e buxhetit për periudhën 2023/25.

Pika e gjashtë: Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për thuarjen e memorandumit të mirëkuptimit në mesë të Komunës së Novobërdës dhe shoqatës vullnetare të zjarrfiksave (SHMZ);

Për këtë pikë Kryesuesja ja dha fjalën D.SH.P zt.Gafurr Vllasaliu.

Gafurr Vllasaliu pasi pershendeti të pranishmit tha: në Komunën e Novobërdës kemi 9 zjarrfikës, prej tyre disa nuk janë në gjendje të mirë shendetësore, andaj duhet që të kemi më shumë punëtorë. Në 244km² të menaxhojm mirë një teritor që është kodrinoro – malor e kemi problem që ta mbulojm të gjithë teritorin më këtë numër të zjarrfiksave dhe pas takimit me AME që është përgjegjëse për zjarrëfiksat Komunitat e Kosovës e kanë shoqatën e vullnetarëve dhe na kanë propozuar që të kemi memorandum të bashkëpunimit me Komunën e Gjilanit, ju faleminderit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime me 13 vota për, 1 apstenim aprovohet kjo pikë nga antarët prezent të Kuvendit dhe mirret ky:

VENDIM

APROVOHET Iniciativa E Kryetarit të Komunes për thuarjen e Memorandumit të mirëkuptimit në mesë të Komunes Novobërdës dhe shoqatës vullnetare të zjarrfiksave Komunes Gjilan (SHVZ).

Pika e shtatë: Me propozim të Komitetit për Komunitete Raportim nga kompania Hidromorava & D.SH.P rreth furnizimit me ujë të pijshëm për ujësjellës nënë mbykqyrje të kompanisë Hidromorava; Kryesuesja tha: e kemi pasur këtë pikë edhe në KPF, në KPF ka qenë një nga Drejtorit e Hidromoraves ku kemi pasur shumë pyetje dhe diskutime, sot siç po shihet nuk është askush prezent nga Hidromorava por a kemi ndonjë zyrtarë që të na informoj më shumë rreth kësaj pike.

Bajram Abazi zyrtarë në shërbime publike pasi pershendeti të pranishmit tha: sa i përket menaxhimit të Kompanisë Hidromorava edhe ne si kompani nuk jemi mjaftë të kënaqur, një ndër arsye është që ata që 2-3 herë i ndërrojnë Drejtorat, menaxhesit e Hidromoraves secili por sa i përket ujësjellësit Makresh – Tullarë – qylkovic që e kanë në menaxhim hidromorava janë tri probleme që ne si Drejtori i kemi identifikuar, problemi i parë është mungesa e ujit, problemi i dytë është problemi me KEDS, problemi i tretë është me personat e pandërgjegjshëm që dalin dhe i ndalojnë ventillat.

Kryesuesja tha: po më vjen mirë që kemi një pikë nga komiteti për komunitete dhe besoj se në një nga Kuvendet e ardhshme do të kemi një informat rreth rreth këtyre ujësjellsave pasi që ka edhe shumë familje të kyçura ilegalisht dhe kemi vazhdimisht ankesa prej qytetarëve.

Pika e tetë: Shpallja e tokës dhe objekteve me rëndësi publike në Komunën e Novobërdës;

Kryesuesja për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Urbanizmit zt.Bojan Peric.

Bojan Peric pasi pershendeti të pranishmit tha: sot e kemi këtë pikë, propozim vendimin për shpalljen e tokave dhe objekteve me rëndësi të veçantë në bazë të ligjeve në fuqi të aprovuara. Ju kerkoj falje sa i përket materialit pasi që perkthimi nuk është realizuar dhe nuk e keni materialin në të dy gjuhët. Një nga lokacionet e shpalljes me rëndësi të veçantë janë edhe tregu në fshatin Llabjan, fabrika e mëhershme e radiatorëve, kopshtet bujqësore, hapsirat në stanishor, parcelat në draganc, një zonë në fshatin Jasenovik dhe Bostan, 2 parcela në Makreshë, mendoj se duhet ta hudheni në votim këtë propozim pasi që nuk ka kohë që të shtyhet si dhe mundë të propozini një pauzë që ta shqyrtoni materialin.

Kryesuesja tha: pasi që kjo pikë ka ardhë sot dhe materiali është vetëm në gjuhën serbe propozoj një pauzë 10-15min që ti shikojmë këto zona.

Kryesuesja tha: besoj se çdo gjë është në bazë të ligjeve në fuqi, po e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pranvera Kastrati Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: unë kerkoj që kjo pikë të shtyhet për një mbledhje të ardhshme, arsyeja është pasi që nuk e kemi materialin me kohë dhe ka gjëra të ndieshme këtu dhe për me pas hapsirë më shumë, më diskutut më shumë është mirë që të shyhet për një mbledhje të ardhshme.

Procesverbali i Kuvendit

Abdyl Gashi tha: pajtohem paraprakisht me kolegen pasi që kjo është mirë që të shihet pasi që ka mundësi me qenë në kundërshtim me ligjet dhe besoj se kjo si pikë ka mu kthyer prej Ministrisë përkatëse. Milica Jovanovic tha: mendoj se duhet të votohet pasi që nuk paska afat kohorë më shumë. Ramush Mehmeti tha: unë i përkrahi mendimet e kolegeve por pasi që qenka afati i fundit mendoj se duhet të votohet e pastaj mbetet Ministrisë se a e aprovojnë apo jo. Pranvera Kastrati Gashi tha: e kuptoj se është afati i fundit por vete fakti se është afati i fundit është dasht pak më heret materialin me dorë. Kryesuesja tha: edhe unë po them se është vonuar por u perkthyer materiali në pauzë, pasi që është propozim i Drejtorisë së Urbanizmit dhe ata janë ekspert ju lutem që ta votoni. Me 12 vota për, 2 kunder (Abdyl Gashi, Pranvera Kastrati Gashi) aprovohet kjo pikë dhe mirret ky:

VENDIM

Për shpalljen e tokës dhe objekteve me rëndësi publike për Komunën e Novobërdës.

Pika e shtatë: Të ndryshme;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Stojan Stanojevic tha: keroj që kompania EkoHigjena të angazhohen më shumë pasi që po kemi probleme me ata në pastrimin e kontinjereve, ose edhe të ndërrohet vendi i kontinjereve.

Kryesuesja tha: kerkoj që të drejtoheni me një kërkesë konkrete.


Abdyl Gashi tha: kerkoj që ndriqimi publikë të funksionoj në të gjitha vendbanimet.

Kryesuesja tha: në shumë fshatra është problem, besoj se së shpejti ai problem do të zgjidhet.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit

